



**REPUBLIKA E SHQIPERISE**  
**KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE**

**V E N D I M**  
**P Ë R**

**DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NË UDHËZIMIN Nr. 1, DATË 31.05.2017 "PËR PËRDORIMIN E MATERIALEVE PROPAGANDISTIKE DHE VENDET PËR AFISHIMIN E TYRE GJATË FUSHATËS ZGJEDHORE"**

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, në mbledhjen e tij të datës 11.04.2019, me pjesëmarrjen e:

Klement	ZGURI -	Kryetar
Denar	BIBA -	Zv/Kryetar
Bledar	SKËNDERI-	Anëtar
Edlira	JORGAQI-	Anëtare
Rezarta	BITRI-	Anëtare

Shqyrtoi çështjen me:

**OBJEKT:** Për disa shtesa dhe ndryshime në udhëzimin nr. 1, datë 31.05.2017 "Për përdorimin e materialeve propagandistike dhe vendet për afishimin e tyre gjatë fushatës zgjedhore".

**BAZA LIGJORE:** Nenit 21 pika 1, nenit 3, pika 5, nenit 77, pika 1, nenit 78, pika 1, nenit 79 dhe nenit 88 të Ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar, neni 24/2, pika 4 dhe 5 të Ligjit nr.8580, datë 17.02.2000, "Për Partitë Politike" i ndryshuar me ligjin nr. 90/2017 "Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8580, datë 17.02.2000, "Për Partitë politike",

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve pasi shqyrtoi dokumentacionin e paraqitur si dhe dëgjoji diskutimet e përfaqësuesve të partive politike,

**VËREN**

Neni 77 pika 1, nenit 78 pika 1, nenit 79 dhe nenit 88 të Ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar, neni 24/2, pika 4 dhe 5 të nr. 8580, datë 17.02.2000, "Për Partitë Politike" i ndryshuar me ligjin nr. 90/2017 "Për disa shtesa dhe



**Nr . 153 i vendimit Data 11.04.2019 e vendimit Ora 12:00 e vendimit**

Për disa shtesa dhe ndryshime në udhëzimin nr. 1, datë 31.05.2017 "Për përdorimin e materialeve propagandistike dhe vendet për afishimin e tyre gjatë fushatës zgjedhore"

ndryshime në ligjin nr. 8580, datë 17.02.2000, "Për Partitë Politike", parashikojnë kufizimet për përdorimin e materialeve propagandistike dhe vendet e lejuara për afishimin e tyre gjatë fushatës zgjedhore.

Për përmbushjen e detyrimeve ligjore që rrjedhin nga dispozitat e sipërcituara, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve ka miratuar udhëzimin nr. 1, datë 31.05.2017 "Për përdorimin e materialeve propagandistike dhe vendet për afishimin e tyre gjatë fushatës zgjedhore".

Referuar nenit 23, pika 4 të Kodit Zgjedhor, aktet normative të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, kanë karakter të përhershëm dhe zbatohen si rregull për të gjitha llojet e zgjedhjeve. Këto akte rishikohen në rast të ndryshimit të ligjit apo për shkaqe të tjera që përlligjin ndryshimin e tyre.

Në lidhje me financimin e fushatave zgjedhore nuk ka ndryshime ligjore, por nisur nga problematikat e shfaqura në zgjedhjet e fundit, OSBE-ODIHR, në raportin përfundimtar për monitorimin e zgjedhjeve të vitit 2017, ka rekomanduar harmonizimin e rregullave për financimin e fushatës zgjedhore dhe aktet nënligjore, me qëllim që të sigurohet një metodologji solide dhe qasje në informacionin e plotë mbi financimin e fushatës zgjedhore për ekspertët financiarë dhe zgjedhësit para dhe pas ditës së zgjedhjeve.

Një nga problematikat e hasura nga zbatimi në praktik i monitorimit të fushatës nga ekspertët financiarë ishte evidentimi i lagjeve si organizimet vendore me të vogla territoriale brenda qyteteve, nga bashkitë si dhe afatet për publikimin e informacionit dhe vënien në dispozicion të subjekteve zgjedhore. Referuar ligjit nr. 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore" njësitë e vetëqeverisjes vendore janë qarqet dhe bashkitë. Bashkitë përbëhen nga disa njësi administrative, të cilat përbëhen nga qytetet dhe fshatrat. Qyteti vet ndahet me vendim të Këshillit të Bashkisë në njësi më të vogla që janë lagjet. Nëpërmjet akteve nënligjore të KQZ-së duhet të qartësohen rregullat dhe afatet, për zhvillimin e fushatës zgjedhore nga subjektet zgjedhore, për ngritjen dhe funksionimin e zyrave elektorale.

Për sa më lart në udhëzimin nr. 1, datë 31.05.2017 "Për përdorimin e materialeve propagandistike dhe vendet për afishimin e tyre gjatë fushatës zgjedhore" lind e nevojshme që të bëhen disa shtesa dhe ndryshime në disa nene të këtij udhëzimi.

## **PËR KËTO ARSYE**

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, bazuar në nenin 23, pika 1, gërma "a", pika 2, 4, dhe 5, të Ligjit Nr. 10019, datë 29.12.2008 "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë" i ndryshuar.



**Nr . 153 i vendimit Data 11.04.2019 e vendimit Ora 12:00 e vendimit**

Për disa shtesa dhe ndryshime në udhëzimin nr. 1, datë 31.05.2017 "Për përdorimin e materialeve propagandistike dhe vendet për afishimin e tyre gjatë fushatës zgjedhore"

## V E N D O S I:

1. Në Udhëzimin nr. 1, datë 31.05.2017, bëhen këto shtesa dhe ndryshime:
  - 1.1 Në fund të pikës 2, të nenit 2 shtohet kjo fjali:

“Bashkia duhet të publikojë vendimin e Këshillit Bashkiak, për ndarjen e qyteteve në lagje dhe shtrirjen e tyre territoriale jo më vonë se 60 ditë para datës së zgjedhjeve.”
  - 1.2 Fjalja e parë e pikës 3, të nenit 2, ndryshohet si më poshtë:

“Subjekti zgjedhor është i detyruar të njoftojë me shkrim Kryetarin e Bashkisë përkatëse, për adresat e sakta të zyrave elektorale jo më vonë se 35 ditë para datës së zgjedhjeve”
  - 1.3 Neni 6 ndryshohet si më poshtë vijon:

“Në rastet e kundravajtjeve administrative, KQZ vendos sanksionet administrative të parashikuara në Kodin Zgjedhor, i ndryshuar dhe Ligjin nr. 8580, datë 17.02.2000, “Për Partitë Politike” i ndryshuar.
2. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë
3. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Kolegjin Zgjedhor pranë Gjykatës së Apelit Tiranë, brenda 5 ditëve nga shpallja e tij.

<b>Klement</b>	<b>ZGURI -</b>	<b>Kryetar</b>
<b>Denar</b>	<b>BIBA -</b>	<b>Zv/Kryetar</b>
<b>Bledar</b>	<b>SKËNDERI-</b>	<b>Anëtar</b>
<b>Edlira</b>	<b>JORGAQI-</b>	<b>Anëtare</b>
<b>Rezarta</b>	<b>BITRI-</b>	<b>Anëtare</b>

